

NJOFTIM PER VEND TE LIRE PUNE

**Intesa Sanpaolo Bank Albania kërkon të punësojë:
Jurist (Specialist)
Departamenti Ligjor - Drejtoria Qëndrore Tiranë**

Përgjegjësitë kryesore:

- Të sigurojë asistencë dhe konsulencë ligjore lidhur me iniciativat dhe produktet e Bankës;
- asistencë lidhur me aspektet e implementimeve ligjore e teknike të platformave të ndryshme digjitale në të gjithë linjat e biznesit dhe juridiksioneve;
- hartimin e kontratave bankare, opinioneve ligjore dhe akteve të tjera ligjore në mbështetje të strukturave të biznesit dhe jo-biznesit përgjatë aktivitetit kredidhënës;
- asistencë ligjore për përgatitjen, hartimin e mbrojtjen ligjore të interesave të Bankës në proceset gjyqësore;
- asistencë për procedurat dhe standardet e prokurimeve, e të tjera.

Eksperiencia e kërkuar:

- 5+ vite eksperiencë në Zyrat e Avokatisë, Subjektet Audituese dhe/ose përvojë në industrinë e shërbimeve financiare e bankare ose institucionet publike e agjencitë shtetërore që lidhen me projektet e investimet zhvillimore.
- Preferohet eksperiencë në njohjen e ligjeve që lidhen me pronësinë e pasurive të paluajtshme/luajtshme dhe praktikës gjyqësore respektive si dhe atyre që realizojnë ofrimin e shërbimeve digjitale.
- Njohje e praktikës gjyqësore dhe procesit gjyqësor civil e administrativ.

Aftësitë e kërkuara:

- Të zotërojë një njohuri e kuptim solid të ligjeve, rregulloreve e kuadrit juridik civil, bankar, legjislacionit në fushën e pronësisë, të marrëdhënieve të punës, së detyrimeve e Kontratave e atij procedural civil, etj.
- Aftësi e njohuri për të hartuar kontrata, për të përgatitur opinione ligjore që identifikojnë risqet juridike dhe mënyrat e zbutjes së tyre, në varësi të kërkesave.

- Njohuri e zotësi për të bërë kërkim ligjor të avancuar, përfshirë dhe praktikën gjyqësore unifikuese vendase e ndërkombëtare për të hartuar aktet ligjore si dhe për të realizuar mbrojtjen e interesave të Bankës në gjykatë e institucionet e tjera ligjzbatuese.
- Aftësi për të asistuar në procesin negociues si dhe njohuri në fushën e prokurimeve.
- Aftësi të forta analitike, sintetizuese e vetë-organizuese.
- Etikë e lartë, disiplinë pune dhe iniciativë.

Kërkesa formale:

- Njohje shumë të mirë të gjuhës angleze dhe mundësisht njohje e mirë e gjuhës italiane, të certifikuara.
- Diplomë Universitare në Jurisprudencë si dhe Diplomë e Masterit Shkencor (nota mesatare e preferueshme mbi 8.5).
- Diploma të tjera që konfirmojnë edukime shtesë.
- Të mos ketë masa disiplinore në dosjen e punësimit.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Një Curriculum Vitae të detajuar.
- Kopje të Diplomës dhe Listës së notave.
- 2 Letra reference nga punëdhënës aktual apo të mëparshëm me numra kontakti të aktualizuar.
- Shembuj punimesh juridike si Kërkesë-Padi, opinione ligjore/kontrata komplekse ose çdo instrument tjetër ligjor i përgatitur nga vetë kandidati.
- Licensë Avokatie

Aplikimet duhet të dorëzohen jo më vonë se data **21 korrik 2024** në adresën: recruiting@intesasanpaolobank.al